


# 2K FactoryStyle

## Ekstra mat



IZOLIMI



Shtresë poliuretani 2K me bazë uji për masa niveluese prej çimentoje. Për dëmtime mjaft të mëdha.


- Me emetime veçanërisht të ulëta me EMICODE EC1 Plus
- Sipërfaqe mat e njëtrajtshme
- Sektor i madh përdorimi, edhe në sektorët publik për shkak të sigurisë kundrejt rrëshqitjes, grupi i vlerësimit R9
- Efikas në kohë nëpërmjet përdorimit në sistemin me 2-shtresa (1x astar, 1x izolim)

### Gama e përdorimit:

I përshtatshëm për finiturën e masave të shpatullash në sipërfaqe përdorimi me bazë çimentoje e autorizuar nga LOBA. Një listë përkatëse e gjeni në: [www.loba.de/Einsatzbereiche/Factory-Linie](http://www.loba.de/Einsatzbereiche/Factory-Linie). Rezistencë ndaj rrëshqitjes sipas grupit të vlerësimit R9 DIN EN 16165:2021-12. Për sforcim të fortë në ambiente banimi si dhe përdorim komercial.

## Të dhëna teknike të produkteve

### Ngarkesa



NR. ARTIKULLI



11743

5 kg

2

96

Niveli i shkëlqimit  
përafërsisht\*

20

Solide

38 ±2%

Viskoziteti

31 ±2s

Magazinimi dhe  
transportimi

12 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit.  
Material i parrezikshëm sipas ADR.  
Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C.  
Mbrojeni nga ngrica.

GISCODE

W2/DD+

2004/42/CE

Vlera e lejueshme i BE-së për produktin (Kat. A/j): 140g/l (2010).  
Ky produkt përmban maksimumi 40g/l VOC (Përzierje me përforsues).

\*Shkalla e shkëlqimit matet në temperaturë 60° në qelq. Varet nga trashësia e shtresës dhe kushtet e ambientit (temperatura, lagështira relative e ajrit) gjatë tharjes. Vlerat janë vetëm indikative.

## Udhëzime përpunimi

- Masa niveluese duhet të jetë e përgatitur në përputhje me informacionet e prodhuesit për përdorim të drejtpërdrejtë.
- Tundeni mirë masën, shtoni forcuesin në raport 10:1 dhe përziejeni duke tundur. Nëse duhet të përzien sasi të pjesshme, përdorni gotën matëse LOBATOOL, ose peshojeni. Pas përzierjes, i përpunueshëm për 1 orë.
- Dyshemeja duhet të jetë e thatë, pa shtresa të vjetra, vaj, yndyra, dyllë, silikon dhe papastërti të tjera. Kushtet optimale të përpunimit eksitojnë në një temperaturë mjedisi nga +15°C - 25°C, temperaturë dyshemeje +15°C - 22°C, lagështirë relative të ajrit 40% - 75%, temperaturë të materialit +18°C - 25°C, ajrosini mjaftueshëm mjediset e punës.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).
- Ky produkt është pjesë integrale e "Connected Systems" të LOBA dhe Wakol për heqjen e skories së masave të shpatullës në sipërfaqe përdorimi me bazë çimentoje. Kombinimet e autorizuara i gjeni në [www.loba.de/produkte/connected-systems/ausgleichsmassen](http://www.loba.de/produkte/connected-systems/ausgleichsmassen)
- Tundni mirë materialin.

### HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

### MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Rul llaku me mikrofibra 100-120 LOBA / rreth 100 ml(g)/m<sup>2</sup> = 10m<sup>2</sup>/l(kg)

### KOHA E THARJES

- Mund të ecet kujdes pas 4 orëve.
- Përdorim i lehtë pas 24 orëve.
- Mundësi përdorimi të plotë dhe mbulimi pas 5 ditësh.
- Mbulimi i shpejtë mundosohet me LOBA Cover 400, për detaje shih informacionet teknike të produktit.
- Koha e tharjes e përmendur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%.

### PËRDORIMI:

#### Përgatitja:

- Aplikoni masa të shpatullës në sipërfaqe përdorimi me bazë çimentoje në përputhje me të dhënat e prodhuesit. Si rregull, mos e fërkoni masën e shpatullës, nëse ka përfshirje, shtypini me një teh të mprehtë.
- Masa të mundshme shpatullash gjeni në listën e masave të shpatullës në sipërfaqe përdorimi me bazë çimentoje në: [www.loba.de/Einsatzbereiche/Factory-Linie](http://www.loba.de/Einsatzbereiche/Factory-Linie). Vini re informacionin teknik përkatës të prodhuesit të masave të shpatullës.

#### Aplikimi:

- Përgatiteni nënshtresën sipas mënyrës së duhur dhe aplikoni astarin OptiPrime FactoryBase sipas informacionit teknik.
- Dora e parë duhet të thahet të paktën për 3 orë, prisni tharjen e plotë.
- Aplikoni me rul 1x llak.

Për detaje të tjera ju lutemi kushtoni vëmendje "Rekomandimi i vendosjes së masave të shpatullës në sipërfaqe përdorimi me bazë çimentoje | llakuar".

#### Kujdesi për ruajtjen e vlerave:

Rekomandime të detajuara për pastrimin dhe kujdesin gjeni te udhëzimet e kujdesit të LOBA "Masat niveluese të çimentuara të llakuara". Këto rekomandime të përgjithshme, si dhe rekomandimet specifike për produktin gjenden gjithashtu në [www.loba.de](http://www.loba.de)

### INFORMACION I RËNDËSISHËM

#### Rezistenca mekanike:

- Rezistente kundrejt ngarkesave të lehta fërkuese ose rrotulluese.

#### Lëngjet:

- Në rastin e një strukture të llakuar sistemi kemi të bëjmë me një sistem të hapur difuzioni.
- Lëngjet duhet të absorbohen menjëherë pasi në rast se veprojnë për një kohë të gjatë mund të kemi ndryshime të ngjyrës.
- Nëse do të shfaqen dëmtime sipërfaqësore (gërvishtje, vrima, prerje etj.), lëngjet mund të futen pa pengesa në masën e stukos.
- Në varësi të ngjyrës vetjake të masës niveluese ose të shtresës sipërfaqësore, papastërtitë dalin më shumë në pah, p.sh. njolla e errët e kafes mbi masën niveluese me ngjyrë të hapur.

Mbi masën e shpatullës të paveshur shkelni vetëm me këpucë me këllëf. Papastërtitë dhe lagështia, që veprojnë në masën e shpatullës, pas përpunimit të sipërfaqes mund të bëhen të dukshme.

## Udhëzime të përgjithshme

**Pastrimi i mjeteve të punës:** Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

**Koha e tharjes:** Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBA Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

**Ndërveprime:** Materialet me përmbajtje plastifikuesi si p.sh. nënshtresat e tapeteve, këmbët e mobilieve, rrotat e karrigeve mund të shkaktojnë zbutje dhe çngjyrosje. Ekspozimi në bojra floku, goma makinash, motorash, biçikletash, gjithashtu mund të shkaktojnë çngjyrosje të përhershme dhe të pandryshueshme të sipërfaqes.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve normale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik. Rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin e masës niveluese dhe normat aktuale duhen respektuar. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjë ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.

Këshilla të tjera mbi temën "dyshemetë dekorative me material nivelues mineral" gjeni në fletëpalosjen e BSR Shoqata Federale e Ekspertëve të Betuar për Ambientet dhe Arredimin e.V. (shoqatë e regjistruar).